

VENDIM
Nr. 257, datë 23.8.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 195, DATË 30.8.2018, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘DERBI-E’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘ANTENA’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1105”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1711/2 prot., datë 18.8.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.8.2018, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Derbi-E’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Antena’ me kapacitet të instaluar 1105kw”,” konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë 30.8.2018, ka vendosur:

“1. Të licencojë shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Antena” me fuqi 1105 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Derbi-E” sh.p.k., në përfundim të afati 5-vjeçar të kontratës së qirasë me Bashkinë Mat, të depozitojë në ERE kontratën e rifreskuar.”.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 195/2018, shoqëria ka depozituar kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Mat për HEC “Antena”, me afat vlefshmërie 10 (dhjetë) vjet, deri më datë 7.4.2033, me të drejtë rinovimi.

- Ky afat nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë, ndaj vlerësohet që pika 2, e vendimit të Bordit nr. 195/2018, të ndryshohet duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë në ERE kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 7.4.2033, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.

- Me shkresën e depozituar në ERE me nr. 1116/4 prot., datë 11.4.2023, shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor me nr. serie 000082, nr. 3 prot., datë 24.2.2023, të miratuar me vendimin nr. 1, datë 8.2.2023, të Këshillit të Basenit Ujq Mat për përdorim të burimit ujq për HEC “Antena”, me një afat 5-vjeçar, deri më 8.2.2028.

- Shoqëria ka qenë e pajisur me leje për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor të vlefshme në momentin e aplikimit, për këtë arsye nuk i është lënë kusht në vendimin e Bordit nr. 195/2018.

- Me depozitim të lejes për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor, lind nevoja të shtohet një pikë në vendimin e licencimit, meqenëse kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar, për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie, nga HEC “Antena”, brenda datës 8.2.2028.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të ndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.8.2018, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Derbi-E” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 7.4.2033, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti, si dhe lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Antena”, brenda datës 8.2.2028.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti